Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1025

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Visar Kuçi" B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e kompleksève memorialë ne komunën e Prizrenit" me numër të prokurimit 622-23-10114-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Kuvendi Komunal i Prizrenit", më 26/02/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e "Visar Kuçi" B.I., me nr. 2023/01025 , e datës 18/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e kompleksève memorialë ne komunën e Prizrenit", me numër të prokurimit 622-23-10114-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Kuvendi Komunal i Prizrenit".

2.Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues "Kuvendi Komunal iPrizrenit",, të datës 29.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 21.09.2023 "Kuvendi Komunal i Prizrenit",në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e kompleksève memorialë ne komunën e Prizrenit", me numër të prokurimit 622-23-10114-5-2-1, Ndërsa me datën 29.11.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit

Kontraktues ka shpërblyer GOE "LIMIT L& B & REHA EPOXID" SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 200,000.00 euro.

Me 03.12.2023, OE "Visar Kuçi" B.I., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 06.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 18.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Visar Kuçi" B.I., me nr. 1025/23 lidhur me aktivitetin "Mirëmbajtja e kompleksève memorialë ne komunën e Prizrenit" me numër të prokurimit 622-23-10114-5-2-1,

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Visar Kuçi" B.I., janë parashtruar si në vijim:

Më datë: 29.11.2023, AK na ka informuar se ka rekomanduar për kontratë GOE; "LIMIT L& B & REHA EPOXID" SH.P.K Me datë 29.11.2023 kemi kërkuar qasje dhe qasja ne dokumente zyrtare tek kjo procedurë na është ofruar me datë 30.11.2023. Ne kemi analizuar në detale ofertën e OE të rekomanduar dhe bazuar në dëshmitë e ofruara nga ky OE kemi vërejtur se AK ka rekomanduar për fitues të këtij projekti një OE I cili nuk I ka plotësuar kërkesat e FDT-së dhe NJK qka nënkupton se AK nuk ka vlerësuar konform nenit 59 të LPP-së.

Pretendimi Nr.1 Në kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional në FDT AK ka kërkuar: Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 300.000,00 euro. Në bazë të dëshmive që ka ofruar GOE I rekomanduar për këtë pikë del që I njëjti nuk e ka plotësuar kërkesën nr.1 të kapacitetit teknik e profesional. Kërkesa prej 300,000.00 dëshmi për realizim të projekteve të ngjashëm nuk është plotësuar sepse në bazë të analizës që I kemi bërë të Listës projekteve te GOE, shuma e kontratave të realizuar në bazë të dëshmive të kërkuara është: 242,346.27 euro. Pra konform nenit 10 të UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, oferta e këtij OE është dashur të refuzohet (Dëshmia 1.1)

Edhe përkundër që AK I ka kërkuar sqarime për kontrata dhe referenca, GOE ju ka përgjigjur AK me të njëjtat dëshmi dhe në përgjigjën e tyre GOE të datës 30.10.2023, në pikën nr.1 e ka konfirmuar se kontratat janë nënshkruar para datës e cila përfshinë periudhën 3 vjeçare nga data e publikimit te njoftimit për kontratë. Ndërsa e ka cekur se janë realizuar gjatë kësaj periudhe 3 vjeçare, por dëshmitë dhe raportet e pagesave në të cilat është thirrur ky GOE, dëshmojnë të kundërtën sepse projektet në bazë të këtyre dëshmive skan raport përfundimtar dhe

raporti I pagesave është para datës e cila e përfshinë periudhën 3 vjeçare, respektivisht janë para datës: 21.09.2020. Po ashtu sa I përket kërkesës për kontrata dhe referenca, GOE I rekomanduar ka ofruar dëshmi RAPORTE PËR PAGESA TË PROJEKTEVE/ SITUACIONEVE të cilat janë dokumente të lëshuara nga vetë AK Komuna Prizren Drejtoria e Administratës, por të cilat nëse analizohen janë I njëjti dokument vetëm ndryshon shuma e situcionit të cilën OE LIMIT e ka dorëzuar në DT. Këto dëshmi janë lehtë të verifikueshme nga AK sepse kemi të bëjmë me dok të lëshuar nga Komuna Prizren e të cilat ne pretendojmë se OE LIMIT I ka ndryshuar datat dhe vlerat dhe nga një situacion ka prodhuar disa dëshmi fiktive. (Shiko te bashkangjitur keni Dëshmia nr. 1.3) Pra GOE nuk e ka plotësuar as kërkesën nr.1 të FDT-së dhe AK në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së ka propozuar për kontratë një OE I cili nuk ka plotësuar kërkesat e FDT-së.

PRETENDIMI NR.2 Si kërkesë nr.2 në FDT është kërkuar: Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri I projektit I cili duhet të jetë ingjinjer I diplomuar I ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion - Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës. -b. Një ingjinjer i diplomuar i arkitekturës ose master i Arkitekturës me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. c. Një ingjinjer i diplomuar ose master i elektrosë me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. -d. nje bachelor te gjeodezisë të licensuar nga AKK. Te inxhinieri i arkitekturës, ne kemi analizuar dëshmitë e ofruara nga ky inxhinier siç janë CV dhe Kontrata të cilat conform kërkesës së FDT-së është dashur që I njëjti ti nënshkruan vetë këto dëshmi. Meqenëse kemi të bëjmë me një staf I cili për ne është I njohur sepse kemi pas bashkëpunim dhe bashkëpunojmë edhe më tutje, kemi vërejtur se nënshkrimi I tijë nuk është I njëjtë me dëshmitë e ofruara nga GEO në emër të tijë. Andaj kemi kontaktuar të njëjtin I cili na ka konfirmuar se edhe CV-ja edhe Kontrata nuk janë të nënshkruara nga ana e tijë. Pra GEO ka mashtruar AK duke ofruar dëshmi në kundërshtim me LPP-në, respektivisht ka bërë shkelje të nenit 99.2 të LPP-së dhe AK duhet ta trajtojë ofertën e tijë sit ë tillë. Si dëshmi po ua ofrojmë, dokumentet që ne kemi si kompani e në të cilat është nënshkrues z.Nexhat Bytyqi, dhe dëshminë e ofruar nga GEO në emër të z. Nexhat Bytyqi, e në të cilat vërehet se nuk janë të njëjta qka e konfirmojnë pretendimin tonë. Si dëshmi e keni nënshkrimin të cilin e ka dorëzuar GOE në emër të z. Nexhat Bytyqi dhe nënshkrimin origjinal të cilin ne e posedojmë të z.Nexhat Bytyqi. (Dëshmia 2.1 dhe 2.2):Pra GOE nuk e ka plotësuar as kërkesën nr.2 të FDT-së dhe AK në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së ka propozuar për kontratë një OE I cili nuk ka plotësuar kërkesat e FDT-së.

PRETENDIMI NR.3 Si kërkesë nr.3 në FDT është kërkuar: Kërkesa 3. Të ketë së paku 10 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës Kërkesa 4.Të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 1 kamion të tonazhit nga 3-10 ton pesha bartëse. b. një bager grupues I tonazhit të mesëm deri 1o ton. GOE në DT ka dorëzuar një listë me 20 punëtor, por dëshmitë e ofruara nga ky GOE nuk janë 10 siç janë kërkuar me FDT. Për këtë qështje AK I ka kërkuar sqarime conform nenit 72 të LPP-së këtij grupi, por I njëjti përsëri nuk ka përmbushur dëshmitë e kërkuara me FDT, sepse CV-të dhe Kontratat e punëtorëve janë vetëm për 7 punëtor të profileve të ndryshme e jo për 10 punëtor siç është kërkuar me FDT. Pra GOE nuk e ka plotësuar as kërkesën nr.3 të FDT-së dhe AK në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së ka propozuar për kontratë një OE I cili nuk ka plotësuar kërkesat e FDT-së."

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, OE "Visar Kuçi" B.I., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 69 të LPP-së. kërkojmë nga OSHP që lëndën ta kthejë në rivlerësim, ta detyroje AK që vlerësimi të behet konform nenit 59 të LPP-së edhe të rekomandoje OE të përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE: *"OE "VISAR KUQI" B.I ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:***"***Mirëmbajtja e kompleksève memoriale ne komunën e Prizrenit" me nr. të Prok: 622-23-10114-5-2-1 Autoriteti Kontraktues, me dat.06. 12 2023 , ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa juaj për rishqyrtim të refuzohet si e pa bazuar për arsyet në vijim:*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22/12/2023 ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1025/23, ndërsa me datë 05/01/2024 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2023/1025 me rekomandimet si në vijim . Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertes shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar se Nuk Pajtohet me raportin e ekspertes shqyrtuese.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertes, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE *"VISAR KUQI" B.I* ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/1025 ka vlerësuar si në vijim:

*Përgjigje ne pretendimet ankimore: "***Lidhur me pretendimin e parë (I):** *ekspertja shqyrtuese fillimisht potencon se kërkesa në dosjen e tenderit është formuluar si në vijim: "Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 300.000,00€". Në ofertën e tenderuesit të rekomanduar ekspertja shqyrtuese ka gjetur se është dorëzuar lista e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit në vlerë totale të realizuar në shumën 523,414.76 euro. Vlen të shtohet se autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar duke kërkuar që te referencat dhe pranimet teknike të pranuara të definohen saktë se cilat punë janë përfunduar brenda tri viteve të fundit para njoftimit për kontratë pasi që në ofertë janë edhe disa procese të paguara vetëm pjesërisht. Me këtë rast tenderuesi i rekomanduar ka kthyer përgjigjen sipas të cilës ka treguar se kontratat e vitit 2020 nga nr. 1 deri 5 janë kontrata të cilat kanë filluar para datë 21.09.2020 që është më herët sesa tri vite para njoftimit për kontratë. Megjithatë ka shtuar se këto kontrata janë realizuar pas datës 21.09.2020 përkatësisht brenda periudhës prej tri viteve para datës së njoftimit për kontratë.Vlen të thuhet se për ankuesin është kontestues vetëm fakti nëse shuma e përgjithshme e këtyre kontratave të prezantuara nga tenderuesi i rekomanduar e arrijnë shumën*

prej 300,000.00 euro sikurse kërkohet me dosjen e tenderit ose jo. Nga vlerësimi i listës së kontratave të realizuara nga tenderuesi i rekomanduar si dhe sqarimet shtesë të dorëzuara me kërkesën e autoritetit kontraktues, ekspertja shqyrtuese vlerëson se tenderuesi i rekomanduar e ka përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit pasi që ka dorëzuar listën e kontratave në shumën mbi 300,000.00 sikurse është kërkuar me dosje të tenderit. Prandaj ky pretendim sipas ekspertes shqyrtuese është pretendim i pabazuar."

"Lidhur me pretendimin e dytë (II): ekspertja shqyrtuese vlerëson se nuk ka as autorizim përkatësisht nuk ka kompetencë ligjore mirëpo nuk ka as kapacitetin e nevojshëm teknik për të vlerësuar pretendimet për falsifikim të nënshkrimit. Për të vlerësuar pretendimet e kësaj natyre palët ankuese duhet të drejtohen te organet kompetente. Prandaj ekspertja shqyrtuese fare nuk është lëshuar në shqyrtimin e këtij pretendimi".

"Lidhur me pretendimin e tretë (III): ekspertja shqyrtuese fillimisht potencon se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar një listë të punëtorëve ku janë evidentuar 20 punëtor si vijon. Në anën tjetër kërkesa e dosjes së tenderit është formuluar si në vijim "Të ketë së paku 10 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës". Vlen të shtohet se autoriteti kontraktues në kuptim të nenit 72 të LPP ka kërkuar sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar lidhur me disa prej këtyre punëtorëve ashtu që tenderuesi i rekomanduar ka dërguar CV dhe përvojën e punës për këta punëtorë sikurse është kërkuar me sqarime shtesë. Sidoqoftë, për operatorin ekonomik ankues është kontestues vetëm fakti nuk janë 20 punëtor të 10 profileve të ndryshme por (sipas ankuesit) janë vetëm 7 punëtorë të profileve të ndryshme. Bazuar në listën e punëtorëve të dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar si dhe sqarimet shtesë të ofruara me kërkesë të autoritetit kontraktues, ekspertja shqyrtuese vlerëson se në rastin konkret është përmbushur kërkesa e dosjes së tenderit nga tenderuesi i rekomanduar pasi që janë dorëzuar jo 10 por 20 punonjës të profileve të ndryshme (mbi 10 sosh). ***Prandaj edhe ky pretendim sipas ekspertes shqyrtuese është i pabazuar."***

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "VISAR KUQI" B.I Argumentimi në raportin e ekspertes shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertes shqyrtuese. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "VISAR KUQI" B.I janë të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues e mbështet ekspertin shqyrtues i cili konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në ketë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli

me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Paneli shqyrtues duke u bazuar ne shkresat e lëndës si dhe rekomandimin e eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa e dosjes së tenderit është formuluar si në vijim: "Projektet e natyrës së kontratës të realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 300.000,00€". Theksojmë se për ankuesin është kontestues vetëm fakti nëse shuma e përgjithshme e këtyre kontratave të prezantuara nga tenderuesi i rekomanduar e arrijnë shumën prej 300,000.00 euro sikurse kërkohet me dosjen e tenderit ose jo. Ndërsa nga vlerësimi i listës së kontratave të realizuara nga tenderuesi i rekomanduar si dhe sqarimet shtesë të dorëzuara me kërkesën e autoritetit kontraktues, Paneli shqyrtues vlerëson se tenderuesi i rekomanduar e ka përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit pasi që ka dorëzuar listën e kontratave në shumën mbi 300,000.00 sikurse është kërkuar me dosje të tenderit. Po ashtu konstatojmë se kërkesa tjetër e dosjes së tenderit është formuluar si në vijim "Të ketë së paku 10 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës, sipas të cilës Autoriteti kontraktues në kuptim të nenit 72 të LPP ka kërkuar sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar lidhur me disa prej këtyre punëtorëve ashtu që tenderuesi i rekomanduar ka dërguar CV dhe përvojën e punës për këta punëtorë sikurse është kërkuar me sqarime shtesë. Sidoqoftë, për operatorin ekonomik ankues është kontestues vetëm fakti nuk janë 20 punëtor të 10 profileve të ndryshme por (sipas ankuesit) janë vetëm 7 punëtorë të profileve të ndryshme. Bazuar në listën e punëtorëve të dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar si dhe sqarimet shtesë të ofruara me kërkesë të autoritetit kontraktues, Paneli shqyrtues vlerëson se në rastin konkret është përmbushur kërkesa e dosjes së tenderit nga tenderuesi i rekomanduar pasi që janë dorëzuar jo 10 por 20 punonjës të profileve të ndryshme.

-Përfundim-

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertes shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - "Kuvendi Komunal Prizren" të datës 29.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e kompleksveve memorialë ne komunën e Prizrenit" me numër të prokurimit 622-23-10114-5-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- OE - **Visar Kuçi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: